



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 4, datë 25.04.2023

PËR
MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR BASHKIA
KAVAJË, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR.2, DATË 27.04.2018
TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, të neneve 11 dhe 12 të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", të ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, të Vendimit Nr.2, datë 27.04.2018 të KKT-së "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Kavajë", i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Kavajë, si dhe referuar Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr. 30 datë 24.04.2023, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Në Planin e Përgjithshëm Vendor Bashkia Kavajë, të miratuar me Vendimin Nr.2, datë 27.04.2018, të Këshillit Kombëtar të Territorit, i ndryshuar, të bëhen ndryshime në dokumentin e:
 - *Rregullores së Planit:*
 - Në nenin 15 me titull "*Madhësia e parcelës*", pas pikës 6 shtohet pika 7;
 - Në nenin 29 me titull "*Rregulla kufizuese në zonat e reja për zhvillim*", pas pikës 1, shtohen pikat 1/1, 1/2, 1/3, 1/4, 1/5 dhe 1/6;
 - Pas nenit 29 me titull "*Rregulla kufizuese në zonat e reja për zhvillim*", shtohen nenet 29/1, 29/2, 29/3 dhe 29/4;
 - Në nenin 32 me titull "*Kriteret e përcaktimit të njësive strukturore*", pas pikës 2 shtohen pikat 3, 4 dhe 5;
 - Neni 36/1 me titull "*Rregullat për zhvillimet në sistemet Urban, Bujqësor dhe Natyror*", ndryshohet;
 - Në nenin 41 me titull "*Zonat A21-Zona të formuara me banesa kolektive*", ndryshohet Kreu "*B-Rregullat e volumit*", pikat 1, 2 dhe 5;



- Në nenin 42 me titull “Zonat A22-Zona të reja”, ndryshohet Kreu “A-Parashikime të përgjithshme, rregullat e përdorimit dhe kushtet e zhvillimit”, pikat 3, 7 dhe Kreu “B-Rregullat e volumit”, pikat 1 dhe 5;
 - Në nenin 44 me titull “Zonat A23-Zona për rrizhvillim”, ndryshohet Kreu “A-Parashikime të përgjithshme, rregullat e përdorimit dhe kushtet e zhvillimit”, pikat 4 dhe 7;
 - Në nenin 45 me titull “Zonat A31-Zona të formuara”, ndryshohet Kreu “A-Parashikime të përgjithshme, rregullat e përdorimit dhe kushtet e zhvillimit”, pika 3;
 - Në nenin 48 me titull “Zona A41-Zona me funksione mikse urbane”, ndryshohet pika 3, gërma “d”;
 - Në nenin 50 me titull “Njësitë K1-A41-04, K1-A41-05, K1-A41-06, K1-A41-07, K1-A41-08, K1-A41-09, K1-A41-12, K1-A41-13, K1-A41-14, K1-A41-15 dhe K2-A41-02”, ndryshohet Kreu “A-Parashikime të përgjithshme, rregullat e përdorimit dhe kushtet e zhvillimit”, pika 7
 - Në nenin 53 me titull “Njësia G1-A41-01”, ndryshohet titulli, Kreu “A-Parashikime të përgjithshme, rregullat e përdorimit dhe kushtet e zhvillimit”, pikat 5, 7, 8 dhe Kreu “B-Rregullat e volumit”, pikat 1, 2 dhe 5;
 - Në nenin 59 me titull “Njësitë G2-A42-01 dhe G2-A42-02”, ndryshohet Kreu “B-Rregullat e volumit”, pikat 1, 2 dhe 5;
 - Në nenin 65 me titull “Zonat S1-Zonë shërbimi”, ndryshohet Kreu “B-Rregullat e volumit”, pikat 1, 2 dhe 5;
 - Në nenin 93 me titull “Zonat B1- Aktivitete ekonomike bujqësore”, në Kreun “B-Rregullat e volumit”, shfuqizohet pika 10.
- Tabelat e treguesve të zhvillimit të njësive strukturore;

sipas Dokumentit të Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Kavajë, bashkëlidhur këtij Vendimi.

2. Ngarkohen Bashkia Kavajë dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për botimin e Vendimit dhe dokumentit shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, si dhe për përditësimin e informacionit GIS dhe platformës e-Harta, sipas ndryshimeve të miratuara.
3. Ngarkohen Bashkia Kavajë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, si dhe autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDLA TOTA

